



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2019:265080

Datë: 02.07.2024

Numri i dokumentit: 05884377

C.nr.511/19

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nderim Musa, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B..., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit B.C., juriste pranë paditëses, kundër të paditurit I.D., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, me objekt kontesti, rimbursim dëmi, vlera e kontestit 2,868.00 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë **18.06.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZHET kërkesëpadia e paditëses B..., me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri I.D., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, që t'ia paguajë paditëses shumën prej 2,868.00 Euro, në emër të rimbursimit të dëmit, me kamatë ligjore sipas mjeteve të deponuara në bankë mbi një vit, pa destinim të veçantë, si dhe shpenzimet e procedurës, **NË TËRËSI SI E PABAZUAR.**

II. DETYROHET paditësja që t'ia paguajë të paditurit shpenzimet e procedurës në shumë prej 239.00 Euro, në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësja B..., me padi, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar që kërkesëpadia të aprovohet në tërësi si e bazuar, dhe të detyrohet i padituri që t'ia paguajë paditëses shumën prej 2,868.00 Euro, në emër të rimbursimit të dëmit, me kamatë ligjore sipas mjeteve të deponuara në bankë mbi një vit, pa destinim të veçantë, si dhe shpenzimet e procedurës, pasi i padituri në momentin e aksidentit ka qenë pa mbulesë siguroese, ku si rezultat i aksidentit, paditësja i ka kompensuar palët e dëmtuara,

ndërsa tani konfrom LSDA-së, dhe LMD-së, ka kërkuar që padia dhe kërkesëpafia të aprovohet si e bazuar. Ka shtuar se i padituri ka pas për detyrim që të kontrolloj, se a ka mbulesë siguruese vetura para përdorimit, ndërsa sa i përket pretendimit të parashkrimit nga i padituri, ka theksuar se nuk qëndrojnë, pasi padia është afatshme.

I padituri, përmes të autorizuarit të tij, në përgjigjen në padi, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar që kërkesëpafia të refuzohet si e pabazuar, pasi është parashkruar konform nenit 357 të LMD-së. Po ashtu ka theksuar se të paditurit i mungon legjitimiteti real pasiv, pasi në bazë të raportit policor, si pronar i automjetit nuk figuron i padituri, andaj, konform nenit 7 par. 1 lidhur me nenin 3 par 1 të LSDA-së, ka kërkuar që kërkesëpafia e paditëses të refuzohet si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë prej 239.00 Euro.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: Raportin policor të aksidentit nr.2012-AR-1840, i datës 18.10.2012, dhe skica e aksidentit; Procesverbalin mbi dëmtimin e automjetit nr.1793/12, i datës 08.11.2012; Ujdinë jashtëgjyqësore të datës 12.02.2012, dhe Listën e pagesave të datës 19.03.2013.

Gjykata pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi:

Nga raporti policor nr.2012-AR-1840, i datës 18.10.2012, vërtetohet fakti, se me datë 18.10.2012, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ku i padituri si vozitës i automjetit VW – 70X0D, me targa..., nuk kishte pasur mbulesë siguruese, respektivisht polisa e sigurimit kishte skaduar.

Nga procesverbali mbi dëmtimin e automjetit nr.1793/12, i datës 08.11.2012, vërtetohen pjesët e dëmtuara të veturës së palëve të dëmtuara, të specifikuara nga paditësja në procedurë administrative.

Nga Ujdia jashtëgjyqësore e datës 12.02.2012, vërtetohet fakti, se paditësja me palën e dëmtuar në aksident ka lidhur ujdi jashtëgjyqësore për shumën prej 2,686.00 Euro.

Nga Lista e pagesave e datës 19.03.2013, vërtetohet fakti, se për palën e dëmtuar Xh.H., është dërguar lista për pagesë, në shumën prej 2,686.00 Euro, aq sa është lartësia e kërkesëpadisë së paditëses.

Me dispozitën e nenit 18 par. 1 të LSDA-së, përcaktohet se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”,* ndërsa me par. 2 përcaktohet se: *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”.*

Me dispozitat e nenit 136 par. 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”.*

Me dispozitën e nenit 245 par. 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Me dispozitën e nenit 960 par. 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”.*

Nga gjendja faktike e konstatuar e me referencë në të drejtën materiale rezultoi pathemelësia e kërkesëpadisë së paditëses, pasi nuk është provuar me prova materiale se paditësja ka bërë përmbushjen e detyrimit ndaj palëve të dëmtuara në aksident, për t'i lindur e drejta për rimbursim dëmi ndaj palës përgjegjëse, respektivisht të paditurit, në kuptim të nenit 960 të LMD-së, lidhur me nenin 18 të LSDA-së.

Nga provat e administruara në shqyrtim kryesor, ndër të tjerash është administruar edhe lista për pagesën e dëmeve e datës 19.03.2013, mirëpo kësaj prove gjykata nuk i'a fali besimin për të vërtetuar faktin se shuma prej 2,686.00 Euro, që kërkohet me kërkesëpadi, t'i jetë paguar palëve të dëmtuara.

Sipas nenit 960 të LMD-së, të cituar më lartë, që siguruesi të mund të kërkojë rimbursimin nga pala përgjegjëse, është thelbësore të sigurohet prova se kompensimi me të vërtetë i është paguar të dëmtuarve.

Kërkesa specifike e përshkruar nga neni 960 të LMD-së, është që të drejtat për të kërkuar rimbursim i transferohen siguruesit vetëm me pagesën reale të dëmshpërblimit për palët e dëmtuara.

Paditësja si dëshmi të vetme ka dhënë Listën e pagesave që dorëzohen në bankë për ekzekutim, mirëpo sipas vlerësimit të gjykatës kjo listë nuk përbën dëshmi të pagesës, sepse Lista e pagesave thjesht tregon një qëllim ose udhëzim për të paguar, i cili nuk plotëson kërkesat e nenit 960 të LMD-së, pasi prova e nevojshme, do të ishte një “Urdhër Transfer Bankar” ose një dokument i ngjashëm që vërteton pa mëdyshje se pagesat janë transferuar dhe pranuar nga të dëmtuarit.

Meqenëse paditësja me asnjë provë të vetme nuk e ka argumentuar se ka përmbush dëmin në lartësinë që kërkon, në kuptim të nenit 7 paragrafi 1 të LPK-së, ku përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, lidhur me nenin 319 paragrafi 1 të LPK-së, ku përcaktohet se: *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar.

Pretendimet e të autorizuarit të paditurit se në këtë rast të paditurit i mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë, sipas vlerësimit të gjykatës nuk qëndron, pasi me dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 të LSDA-së, përcaktohet se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”*, ndërsa me paragrafin 2 përcaktohet se: *“Byroja ka të drejtë regresive për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*.

Gjykata vlerëson se i padituri si një shofer i licencuar, ka për detyrë të kujdeset që automjeti që ai drejton është i përshtatshëm për rrugë dhe përputhet me të gjitha kërkesat ligjore, duke përfshirë mbulimin e vlefshëm të sigurimit, pasi është brenda aftësive dhe përgjegjësisë së shoferit të verifikojë nëse automjeti ka sigurimin e duhur përpara përdorimit. Fajësimi i pronarit të veturës për mungesën e sigurimit nuk e çliron shoferin nga përgjegjësia për t’u siguruar që mjeti që drejton ka mbulesë siguruese, prandaj, dështimi i të paditurit në këtë drejtim tregon neglizhencë nga ana e tij, dhe si i tillë, përgjegjësia për aksidentin, në kuptim të nenit 18 paragrafi 4 të LSDA-së, bie mbi të si “personi përgjegjës”, andaj, edhe i padituri ka legjitimitet real pasiv për të qenë i paditur.

I autorizuari i të paditurit në deklaratimet e tij ka theksuar kundërshtimin e parashkrimit të kërkesëpadisë, mirëpo përderisa nuk është provuar fakti se kur është paguar dëmi ndaj palëve të dëmtuara, rrjedhimisht nuk mund të vërtetohet as koha se kur ka filluar të rrjedh parashkrimi, pasi me dispozitat e nenit 341 par. 1 të LMD-së, përcakohet se: *“Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit”*, me dispozitën e nenit 342 par. 2 të LMD-së, përcakohet se: *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Ndërsa me dispozitën e nenit 357 par. 1 të LMD-së, përcakohet se: *“Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin”*.

Prandaj, në kuptim të dispozitave të sipërcituar, për t'u shkaktuar parashkrimi, kërkohet plotësimi i dy kushteve në mënyrë kumulative, dhe atë të dihet se kur i dëmtuari ka marrë në dijeni për dëmin, dhe kush është personi që ka shkaktuar dëmin. Në rastin konkret sipas pretendimeve të paditëses shkaktar i aksidentit është i padituri, mirëpo për të marrë si të bazuar apo jo kundërshtimin e të paditurit se kërkesëpadia e paditëses është parashkruar, duhet të vërtetohet edhe kushti tjetër, dhe atë, se cili është dëmi që pretendohet, dhe që duhet të provohet me prova, e që në rastin konkret nuk është provuar nga paditësja se shuma e kërkuar prej 2,868.00 Euro, është përmbushur ndaj të dëmtuarve.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi konform nenit 449 lidhur me nenin 452 të LPK-së.

Nga të cekurat në kuptim të nenit 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.511/19, të datës 18.06.2024

Gjyqtari
Nderim Musa

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.